



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 204, datë 04.10.2021

MBI

**PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR HEQJEN E LICENCËS
ME NR. 248, SERIA PV14K, PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “HIDROPOWERPLANT CONSTRUCTION”
SH.P.K., ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 94, DATË 06.10.2014, I
NDRYSHUAR”**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 95 dhe nenit 113, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 44/2015; nenit 7, 8 dhe 9, të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017; si dhe nenit 15, të Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 04.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 124/2 prot., datë 30.09.2021, të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 190, datë 10.09.2021 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 248, seria PV14K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HIDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k. me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 06.10.2014, i ndryshuar”,

Konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 190, datë 10.09.2021, vendosi për fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 248, seria PV14K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HIDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 06.10.2014, i ndryshuar.
- Ky vendim u mor për arsye se shoqëria “HIDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k., nuk kishte shlyer në afat ndaj ERE-s pagesën rregullatore të vitit 2020 për licencën për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike e po ashtu nuk kishte depozituar në ERE asnjë dokument apo argument në lidhje me moszbatimin e këtij detyrimi.

- Me shkresën nr. 947 prot., datë 15.09.2021, shoqëria është njoftuar për vendimmarrjen si më sipër, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t'u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi.
- Referuar afateve të përcaktuara nga ERE në njoftimin e dërguar për dijeni të subjektit, rezulton se shoqëria i ka shlyer detyrimet e prapambetura brenda afatit dhe nuk është më debitore ndaj ERE-s.
- Në nenin 8, të *Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr.58, datë 18.04.2017, parashikohet se: *“Pas marrjes së përgjigjes me shkrim nga i licencuari sipas parashikimeve, personat e ngarkuar që ndjekin këtë procedurë, do të shqyrtojnë këtë përgjigje brenda 30 ditëve dhe do të përgatisin një relacion për Bordin mbi argumentat e paraqitur dhe veprimet e ndërmarra nga i licencuari, dhe do t'i propozojnë Bordit: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës në rast se i licencuari dëshmon mungesën e kushteve të përcaktuara në pikat "a", "b", "c", "ç" dhe/ose "d", të nenit 5, të kësaj rregulloreje”*.
- Në nenin 95, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, parashikohet se: *“Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur”*.
- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të dispozitës së mësipërme, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave faktike dhe shlyerjes në masën 100% vlerës së debisë nga shoqëria “HIDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k.
- Vërtetimi i shlyerjes së pagesave të prapambetura, fakton ndryshimin e statusit të subjektit, të cilit i kundrejtohet masa administrative, duke rezultuar në rënien e shkakut që çoi marrjen e masës për fillimin e procedurës për heqjen e licencës.
- Në nenin 9, germa “a”, të *Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 58, datë 18.04.2017, parashikohet se: *“Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për: a) të mbyllë procedurën për heqjen e licencës”*.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Përfundimin e procedurës administrative për heqjen e licencës nr. 248, seria PV14K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HIDROPOWERPLANT

CONSTRUCTION” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 06.10.2014, i ndryshuar”.

2. Shfuqizimin e vendimit të bordit të ERE-s nr. 190, datë 10.09.2021 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 248, seria PV14K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “HIDROPOWERPLANT CONSTRUCTION” sh.p.k., me vendimin e bordit të ERE-s nr. 94, datë 06.10.2014, i ndryshuar”.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë të licencuarin dhe palët e interesit për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit AHMETI